

**VENDIM**  
**Nr.616, datë 21.12.1999**

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM TË PROJEKTIT TË SHËRBIMEVE BUJQËSORE DHE TË  
MARRËVESHJES NDËRMJET QEVRIË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PARADHËNIE PËR  
PËRGATITJEN E PROJEKTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

- 1.Miratimin, në parim, të projektit të shërbimeve bujqësore.
  - 2.Miratimin, në parim, të marrëveshjes me shkëmbim letrash, ndërmjet qeverisë së republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për paradhënien prej 554 730 (pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë) USD-sh, për projektin e shërbimeve bujqësore.
  - 3.Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të krijojë njësinë e menaxhimit të projektit dhe të përdorë fondet e paradhënies, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**